



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 2574 Prot.

Gramsh, më 05.02. 2021

V E N D I M

Nr. 01, datë 29/01 / 2021

PËR

**DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR “PËR VEPRAT E MARRJES + DEKANTUESIT, BAZENET I PRESIONIT DHE GODINAT E HEC-VE”, NGA SHOQËRIA “ROVES ENERGY” sh.p.k.**

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 29.01.2021, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor mbështetur në KPA në Republikën e Shqipërisë: Bazuar në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 3shkronja “ç”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b” dhe 1.2 shkronja “a dhe c”, si dhe neni 54 shkronja “e dhe e/1”, neni 55 pika 3 dhe 6 ; Ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe entece publike”, Ligjin nr 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin e zhvillimin e territorit”, Ligjit nr.9385,datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike,sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.591, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.1353,datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik,si dhe të kriterëve e të procedurave e të zvogëlimit të sipërfaqes e të vellimit të fondit pyjor” të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.592,datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime ne Vendimin nr.1374,datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen,shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, të ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrit Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr.01,datë 08.06.2016 “Për rregullat,proçedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, Këshilli Bashkiak:

## VENDOSI :

1. Miratimin për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore prej 0.241 ha (për veprat e marrjes + dekantuesit , bazenet i presionit dhe godinat e Heceve) që do ndërtohet nga shoqëria “ ROVES ENERGY” sh.p.k, fond pyjor/kulloror që ndodhet në territorin administrative të Bashkisë Gramsh.
2. Shprehja e dakorësisë do t'i dërgohet Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit , për vijimin e procedurave ligjore të heqjes nga fondi pyjor/kulloror.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**XHULIA GJINI**

**Konceptoi: Xhulia Gjini**

**Miratoi: Greta Lena**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**GRETA LENA**

